

Nr. 66 prot

Ni. 130 Prot
Datë 20/02/2026

Tiranë, më 17 Shkurt 2026

Drejtuar Hekurudha Shqiptare

Koordinatori për te Drejten e Informimit, Domeniko Sinjari, domeniko.sinjari@hekurudha.al

Rrug Egnatia, Lagjja nr.3, Durres

Lënda Kërkesë për informacion në bazë të ligjit 119/2014

Të nderuar,

ne baze te ligjit 119/2014 i ndryshuar, dhe referuar auditimeve te KLSH, kerkoj informacionet e meposhtme:

1. Si ka mundësi që Hekurudha Shqiptare ka operuar për një vit e gjysmë pa licencë dhe certifikatë sigurie, duke rrezikuar hapur jetën e udhëtarëve dhe sigurinë e mallrave?

2. Me detyrime që tejkalojnë 3.8 miliardë lekë dhe me asete minimale, a jeni të vetëdijshëm se kompania është teknikisht e falimentuar dhe pse nuk është marrë asnjë masë për ristrukturim apo shpallje falimentimi?

3. Përse keni blerë traversa druri pa asnjë standard europian dhe pa certifikatë garancie, duke shpërdoruar fondet për materiale që nuk sigurojnë qëndrueshmërinë e linjave hekurudhore?

4. Pse nuk keni regjistruar në Kadastër pronat e Hekurudhës, duke lejuar që tokat dhe godinat e saj të zihen nga të tretët apo të tjetërsohen pa asnjë përfitim për kompaninë?

5. Si shpjegohet që nuk ka asnjë sistem kontrolli për konsumin e karburantit të lokomotivave, duke pranuar çdo faturë pa verifikuar nëse karburanti është djegur për transport apo është vjedhur?

6. Pse vazhdoni të shkarkoni punonjës në mënyrë të paligjshme, duke i shkaktuar kompanisë një dëm prej 11 milionë lekësh nga vendimet gjyqësore, në një kohë kur nuk keni para as për rroga?

7. Përse jepni me qira asetet e hekurudhës me çmime shumë nën vlerën e tregut dhe pse nuk arkëtoni as këto të ardhura minimale nga subjektet private?

Ju faleminderit,